

NJOFTIM

Sot, më datë 20.05.2026, ora 14:30, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, Kërkesëpadinë Nr.1 Regjistri Themeltar Dt.12.05.2026 Regjistrimi, me:

PADITËSE: Partia Demokratike, përfaqësuar nga Z.Franci Nuri.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ, përfaqësuar nga Z.Blendi Kodra dhe Znj.Ina Osmanaj.

PERSON I TRETË: Partia Socialiste, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimin e Vendimit nr.6, datë 14.04.2026 të Komisionit Rregullator, të KQZ¹ “Për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin e listës së zgjedhësve dhe krijimin e komisionit të qendrës së votimit për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore” si një akt i kundërligjshëm dhe antikushtetues.

BAZA LIGJORE: Neni 3, 8, 19, pika 1, 20, neni 43, 62, nenet 123/1, 123/2, 123/3, 124, 125, 127, nenet 145, 156, 152, 153 e vijues të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar;
Nenet 3, 45, 81/2, 116 të Kushtetutës;
Nenet 12 dhe 14 të Kodit Civil;
Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe e Kolegjit Zgjedhor (*Rrogzhina 2023*);
Nenet 14, 16, 18 i Ligjit për Gjendjen Civile, i ndryshuar;
Nenet 107-109 e vijues të Kodit të Procedurës Administrative.

Çështja u shqyrtua në trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

1. Lutfije Celami (Relatore);
2. Entela Shedula (Anëtare);
3. Rexhep Bekteshi (Anëtar);
4. Artan Çupi (Anëtar);
5. Enkel Peza (Anëtar).

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me Vendimin Nr.1 Dt.20.05.2026, unanimisht:

VENDOSI

1. Pezullimin e zbatimit të Vendimit nr.6, datë 14.04.2026 të Komisionit Rregullator, të KQZ “Për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin e listës së zgjedhësve dhe krijimin e komisionit të qendrës së votimit për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore”.
2. Pezullimin e gjykimit të çështjes me nr. 1 Akti datë regjistrimi 12.05.2026 me paditës Partia Demokratike, me të paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe me person të tretë Partia Socialiste, me objekt: *Shfuqizimin e Vendimit nr.6, datë 14.04.2026 të Komisionit*

¹Komisioni Rregullator në KQZ, me Vendim Nr.6 Dt.14.04.2026, objekt i kërkesëpadisë, me shumicë votash, ka vendosur: “Neni 1: Ky vendim përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin dhe administrimin e listës së zgjedhësve në Institucionet e Ekzekutimit të Veprave Penale (IEVP), si dhe krijimin e komisioneve të qendrës së votimit (KQV) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. ... Neni 6: 1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 2. Ngarkohen kryetarët e bashkive, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, zyrat e gjendjes civile në bashki, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zbatimin e këtij vendimi. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.”.

Rregullator, të KQZ “Për krijimin e qendrave të posaçme të votimit, hartimin e listës së zgjedhësve dhe krijimin e komisionit të qendrës së votimit për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore”.

3. T i kërkojë Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë nenin 18 të Ligjit nr. 10129 datë 11.05.2009 ‘Për Gjendjen Civile’ nrdryshuar me Ligjin nr. 56 datë 06.06.2024, me përmbajtjen si vijon:

“1. Për shtetasit që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo janë vendosur në institucionet e paraburgimit ose shtetasit që qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore për kurim afatgjatë dhe që përfshin qëndrimin e tyre në to edhe datën e zgjedhjeve, vendbanim për qëllime të zbatimit të legjislacionit për zgjedhjet konsiderohet adresa e institucionit përkatës.

2. Institucionet përkatëse jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit që qëndrojnë në këto institucione në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nëpërmjet zyrave përkatëse të gjendjes civile dhe sipas përcaktimeve të ligjit për zgjedhjet harton dhe printon listat e zgjedhësve për këta shtetas që deri në datën e zgjedhjeve ndodhen në këto institucione. Këtyre shtetasve iu mundësohet votimi në qendrën e votimit të krijuar, sipas ligjit zgjedhor në këto institucione. Lista e zgjedhësve e hartuar sipas këtij neni është e vlefshme vetëm për zgjedhjet e radhës dhe ripërsëritet sipas të njëjtave modalitete për çdo zgjedhje.

3. Ministri përgjegjës për gjendjen civile dhe ministri i Drejtësisë përcaktojnë me udhëzim të përbashkët rregullat e njoftimit dhe bashkëpunimit të institucioneve për këta shtetas, procedurën e çregjistrimit dhe regjistrimit të gjendjes civile të vendbanimit për qëllime zgjedhore sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen.’, pasi vjen në kundërshtim me nenet 81 pika 2, gërma “c” dhe nenit 38 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

4. Urdhërohet sekretaria gjyqësore që një kopje të këtij vendimi t`ua njoftojë palëve dhe të kryejë veprimet përkatëse për dërgimin e dosjes në Gjykatën Kushtetuese.

Tiranë, më 20.05.2026.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë